



Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete

Raport për Gjykatën Ekonomike të Kosovës

Korrik 2009

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	- 2 -
I. HYRJE	- 3 -
II. KORNIZA LIGJORE	- 4 -
A. Ligjet e zbehin kompetencën e Gjykatës ekonomike.	- 4 -
B. Kompetenca e bazuar kryesisht në identitetin e palëve është kundër idesë të një gjykatë të specializuar në lloje të caktuara të kontesteve.....	- 6 -
C. Terminologjia e vjetruar, e padefinuar dhe e paqartë e bëjnë të paqartë se cila është kompetenca lëndore e gjykatës	- 7 -
D. Ekzistimi i gjykatave të ndryshme me kompetencë të njëjtë	- 8 -
E. Zvogëlimi i numrit të lëndëve në gjykatë vë në pyetje nevojën për një gjykatë ekonomike në formën e tashme	- 11 -
III. PRAKTIKA E GJYKATËS EKONOMIKE	- 11 -
A. Shkelja e garancive për dëgjim publik nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut	- 11 -
B. Aktgjykimet e Gjykatës Ekonomike shpeshherë nuk kanë arsyetim të mjaftueshëm.....	- 12 -
IV. KONKLUDIM.....	- 15 -
V. REKOMANDIMET.....	- 15 -

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport vlerëson punën e Gjykatës Ekonomike të Qarkut të Prishtinës.¹ Përmes analizave të ligjeve relevante dhe monitorimit të rasteve individuale, janë identifikuar probleme të mëdha të cilat duhet të adresohen në mënyrë që gjykata ta përmbush mandatin e saj me sukses.

Gjykata Ekonomike ka kompetencë të shkallës së parë në “kontestet reciproke ekonomike”, “kontestet për kompensimin e dëmit”, “kontestet ekonomike” dhe, mes tjerash, “kontestet administrativo-llogaritare”.² Për më tepër, ligji i jep gjykatës kompetencë në procedurat e ujdisë së detyrueshme, të falimentimit dhe të likuidimit të rregullt, si dhe të gjitha kontestet që lindin gjatë dhe me rastin e ekzekutimit të këtyre procedurave.³

Ndryshimet e mëdha ligjore, ekonomike dhe politike që kanë ndodhur pas themelimit të Gjykatës Ekonomike e vënë në pyetje nevojën për këtë gjykatë në formën e saj të tashme. Korniza ligjore me të cilën themelohet gjykata dhe përcaktohet kompetenca e saj daton nga viti 1978, në kohën e sistemit komunist në Jugosllavi.⁴ Terminologjia e saj është shpesh e vjetruar, e padefinuar dhe e paqartë. Më tej, legjisllacioni i ri i miratuar në vitet e fundit ka kufizuar kompetencën e gjykatës duke i dhënë kompetencë gjykatave tjera dhe ndonëse rregullat e kompetencave shumëfishohen, ato rezultojnë në zvogëlim të fuqisë së Gjykatës. Për më tepër, gjykata e bazon kompetencën e saj në identitetin e palëve, në vend të lëndës së kontestit, një praktikë që shkon kundër idesë së një gjykate të specializuar në lloje të caktuara të kontesteve. Veç kësaj, ekzistenca e gjykatave të ndryshme me kompetencë të njëjtë ua lejon palëve të zgjedhin “kompetencën apo gjykatën më të favorshme ku mund të shqyrtohet kërkesa...”(*preferencë ndaj një gjykate*),⁵ kontestet e kompetencave dhe vonesat. Përfundimisht, publiku është i hutuar lidhur me çështjen e kompetencës, që ndikon negativisht në menaxhimin e gjykatës. Të gjithë këta faktorë kanë kontribuar në zvogëlimin e numrit të lëndëve të gjykatës.

Nga një këndvështrim praktik, janë identifikuar dy çështje madhore. Së pari, dështimi i gjykatës për t'i publikuar aktgjykimet, për të mbajtur seanca dëgjimore në dhoma që kanë hapësirë të mjaftueshme për publikun, dhe dështimi për t'i shpallur oraret e gjykimeve shkelin garancitë e dëgjimit publik të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Së dyti, aktgjykimet e Gjykatës Ekonomike shpeshherë nuk përmbajnë

¹ Sipas Rezolutës 1244 së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka mandat për të monitoruar sistemin gjyqësor në Kosovë për përputhshmëri me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. OSBE-ja filloi me monitorimin e rasteve penale në vitin 1999 dhe e zgjeroi monitorimin e saj në raste civile në vitin 2004. OSBE-ja filloi me monitorimin e rasteve pronësore si çështje me prioritet që nga viti 2004. Metodologjia e saj e monitorimit të gjykatave përfshin grumbullimin e të dhënave për procedura gjyqësore individuale dhe analizimin e tyre për modele të praktikave problematike gjyqësore ose shkeljeve të ligjeve të zbatueshme në Kosovë.

² Neni 30, Ligji mbi gjykatat e rregullta, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr. 21/1978 (Ligji mbi gjykatat e rregullta). Versioni i përkthyer në gjuhën angleze i Ligjit mbi gjykatat e rregullta përdor kryesisht termin “gjykata ekonomike e qarkut”, por në këtë raport përdoret termi “gjykata ekonomike”. Termet tjera do të definoohen më vonë në këtë raport.

³ Neni 30(2), Ligji mbi gjykatat e rregullta.

⁴ Ligji mbi gjykatat e rregullta.

⁵ Brian A. Garner, Fjalori “Black’s Law Dictionary”, botimi i tetë, Thomson West, 1999, faqe. 681.

arsyetim të mjaftueshëm, duke ngritur kështu brenga tjera nga aspekti i të drejtave të njeriut.

Raporti përfundon me rekomandime për mënyrat se si të tejkalohen problemet e identifikuar.

I. HYRJE

Ligjet ekonomike luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen ekonomike. Rregullat e qarta, të zbatuara në mënyrë konsistente dhe të parashikueshme nga gjykata të pavarura dhe profesionale, ulin koston e transaksioneve dhe ndihmojnë në promovimin e sundimit të ligjit. Kosova ka një legjislacion në zhvillim të ligjeve ekonomike. Ky legjislacion duhet të zhvillohet krahas tranzicionit të shpejtë dhe pothuaj të përfunduar të Kosovës nga një ekonomi socialiste në një ekonomi të tregut të lirë, në mënyrë që të krijojë një hapësirë mundësuese për transaksione ekonomike dhe të kontribuojë kështu në rritje të qëndrueshme ekonomike.

Ky raport përqendrohet në funksionimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, e cila mbulon të gjitha rajonet e Kosovës. Ligji mbi Gjykatat e Rregullta themelon Gjykatën ekonomike, duke i dhënë kompetencë të shkallës së parë në “konteste reciproke ekonomike”, “konteste për kompensimin e dëmeve”, “konteste ekonomike” dhe, mes tjerash, “konteste administrativo-llogaritare.”⁶ Për më tepër, ligji i jep gjykatës kompetencë në procedurat e ujdisë së detyrueshme, të falimentimit, likuidimit të rregullt, si dhe në kontestet që lindin nga ato procedura.⁷ Gjykata ka kompetencë të “vendosë dhe të zbatojë ekzekutimin e vendimeve që ka marrë në shkallë e parë, si dhe kontestet që lindin gjatë dhe me rastin e ekzekutimit të atyre vendimeve, me kusht që zbatimin e ekzekutimit në mjetet jomonetare të të përmbuarit t’ia besojnë gjykatës komunale.”⁸

Në fillim Kosova kishte dy gjykata ekonomike, një në Gjakovë e një në Prishtinë.⁹ Megjithatë, duke i pasur parasysh zhvillimet politike në rajon, gjykata e Gjakovës u mbyll në janar 1992.¹⁰ Gjatë kohës sa Gjykata Ekonomike në Gjakovë ishte funksionale, të dy gjykata kishin të punësuar shtatëmbëdhjetë gjykatës të specializuar në fusha të ndryshme.¹¹ Sot, Gjykata Ekonomike e Prishtinës ka shtatë gjykatës.¹² Këshilli Gjyqësor i Kosovës,¹³ që është autoriteti qendror përgjegjës për administrimin e gjykatave të Kosovës, caktoi tre nga këta gjykatës në Gjykatën e

⁶ *Po aty*, neni 30(1).

⁷ *Po aty*, neni 30(2).

⁸ *Po aty*, neni 30(4).

⁹ *Po aty*, neni 36.

¹⁰ Intervistat e zhvilluara nga punonjësit e OSBE-së me gjykatësit dhe ish-punonjësit e Gjykatës Ekonomike nga janari deri mars 2009.

¹¹ Intervistat e zhvilluara nga punonjësit e OSBE-së me gjykatësit dhe punonjësit e Gjykatës Ekonomike gjatë vjeshtës 2008.

¹² Në kohën e përpilimit të këtij raporti Misioni i Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) nuk ishte i përfshirë në rastet e Gjykatës Ekonomike. EULEX mori kompetencat e plota të veprimit më 6 Prill 2009. Shih :“Raporti i EULEX në OKB” i 17 Qershorit 2009, i qasshëm në faqën zyrtare të EULEX-it : <http://www.eulex-kosovo.eu>

¹³ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/52 mbi themelimin e Këshillit gjyqësor të Kosovës, 20 dhjetor 2005. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është trashëgimtar i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/8, mbi themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, 6 prill 2001.

Qarkut të Prishtinës,¹⁴ por është e paqartë nëse caktimi i gjykatësve është i përkohshëm apo i përhershëm.

II. KORNIZA LIGJORE

Ndryshimet e mëdha ligjore, ekonomike dhe politike që kanë ndodhur pas themelimit të Gjykatës Ekonomike e vënë në pyetje nevojën për vazhdimin e kësaj gjykate në formën e saj të tashme. Korniza ligjore me të cilën themelohet gjykata dhe përcaktohet kompetenca e saj daton nga viti 1978, në kohën e sistemit komunist në Jugosllavi.¹⁵ Terminologjia e tij është shpesh e vjetruar, e padefinuar dhe e paqartë. Më tej, legjislati i ri i miratuar në vitet e fundit ka kufizuar fuqinë e gjykatës duke i dhënë kompetencë gjykatave tjera, deri sa rregullat e kompetencave ndonjëherë rezultojnë në zvogëlim të fuqisë së gjykatës. Për më tepër, gjykata e bazon kompetencën e saj në identitetin e palëve, në vend të temës së kontestit, një praktikë që shkon kundër idesë së një gjykate të specializuar në lloje të caktuara të kontesteve. Veç kësaj, ekzistenca e gjykatave të ndryshme me kompetencë të njëjtë kontribuon në preferencë ndaj një gjykate, kontestime të kompetencës dhe vonesa. Përfundimisht, publiku është i hutuar lidhur me çështjen e kompetencës dhe prandaj kjo ka ndikuar negativisht në menaxhimin e gjykatës.

A. Ligjet e zbehin kompetencën e Gjykatës ekonomike.

Ligji i 1978 mbi Gjykatat e Rregullta përcakton kompetencat e gjykatave të Kosovës dhe i jep Gjykatës Ekonomike kompetencë në shkallë të parë në procedura që përfshijnë, mes tjerash:

- Kontestet reciproke ekonomike, përfshi këtu kontestet rreth kontratave;
- Kompensimin për dëme kur palët ndërgjyqëse janë ndërmarrje të udhëhequra nga punëtorët (“organizatat e punës së bashkuar”) ose organizata tjera shoqërore siç janë sindikatat e punëtorëve, bordet e shërbimeve komunale, dhe komunat¹⁶ (të përmendura në ligj si “organizatat ose bashkësitë e tjera vetëqeverisëse dhe bashkësitë shoqërore-politike”);
- Deliktet ekonomike;
- Kontestet ekonomike që kanë të bëjnë me pronën intelektuale dhe konkurrencën;
- Kontestet administrativo-llogaritare;
- Ujdinë e detyrueshme; dhe
- Procedurat e falimentimit dhe kontestet që dalin nga ato.¹⁷

Megjithatë, rrethanat e pas 1999 në Kosovë sollën shumë ndryshime në sistemin ligjor të Kosovës, duke përfshirë paraqitjen e ligjeve mbi kontratat për shitjen e mallrave, falimentimin, konkurrencën, tregtinë e brendshme, patentimin, markat tregtare, të drejtat e autorit, dhe organizatat e biznesit.¹⁸ Këto shpesh përmbajnë dispozita që

¹⁴ *Po aty.*

¹⁵ Neni 30, Ligji mbi gjykatat e rregullta.

¹⁶ Faqe 11, paragrafi i parë, Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, 1974.

¹⁷ *Po aty.*

¹⁸ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/68 mbi kontratat për shitjen e mallrave, e 29 dhjetorit 2000; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/7, për shpalljen e Ligjit nr. 2003/04 mbi likuidimin dhe

caktojnë gjykata tjera në vend të Gjykatës Ekonomike që të merren me konteste. Nëse ato nuk e revokojnë në mënyrë specifike kompetencën e Gjykatës ekonomike, dispozitat e tyre janë shpesh aq të paqarta sa që e vënë në pyetje fuqinë e Gjykatës Ekonomike për të vendosur mbi raste të caktuara.

Për shembull, ligji i 1978 mbi gjykatat e rregullta u jep gjykatave të qarkut kompetencë mbi rastet e pronës intelektuale në përgjithësi (përfshirë këtu markat tregtare dhe të drejtat e autorit)¹⁹ dhe i jep Gjykatës Ekonomike kompetencë në “kontestet ekonomike” lidhur me pronën intelektuale, duke përfshirë markat tregtare dhe të drejtat e autorit.²⁰ Megjithatë, Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të përafërta i vitit 2006 i jep Gjykatës së Qarkut të Prishtinës kompetencë ekskluzive mbi kontestet nga të drejtat e autorit²¹ dhe mbi artikujt e konfiskuar si pjesë e kontestit nga të drejtat e autorit pranë gjykatës për kundërvajtje,²² duke i hequr këto konteste tërësisht nga kompetenca e Gjykatës ekonomike.

Ligji i 2006 për markat tregtare e përkufizon “gjykatën” si “gjykatën kompetente në Prishtinë”.²³ Kjo mund të kuptohet si mbajtje e kompetencës nga Gjykata Ekonomike në raste të markave tregtare, ndonëse është e paqartë përse kompetenca e saj do t’i hiqej në konteste të të drejtave të autorit ndërsa do t’i ruhej në raste të markave tregtare. Megjithatë, Ligji për Markat Tregtare duket se ndryshon një aspekt të kompetencës së Gjykatës ekonomike, duke përcaktuar që “pa paragjykuar kompetencat që i jep ligji i tanishëm gjykatës (së Prishtinës), kërkesa për dorëzimin, shkatërrimin, apo konfiskimin e materialit kundërvajtës mund të paraqitet në gjykatën që ka kompetencë mbi territorin në të cilin gjinden artikujt e dyshuar ose në të cilin gjendet subjekti që i ka artikujt në posedim, nën kujdesin, ose kontrollin e tij.”²⁴

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta gjithashtu i jep Gjykatës Ekonomike përgjegjësi për mbajtjen e regjistrit të shoqërive tregtare.²⁵ Megjithatë, Ligji për Shoqëritë tregtare ia

riorganizimin e personave juridikë në falimentim, i 14 prillit 2003 (Ligji për falimentimin); Rregullorja e UNMIK-ut nr 2004/44, për shpalljen e Ligjit nr. 2004/36 për Konkurrencën, i 29 tetorit 2004; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/43, për shpalljen e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme, i 20 tetorit 2004; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/56, për shpalljen e Ligjit nr. 2004/49 për patentim, i 20 tetorit 2004; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/38, për shpalljen e Ligjit nr. 02/L-54 për markat tregtare, i 28 qershorit 2006 (Ligji për markat tregtare); Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/46, për shpalljen e Ligjit nr. 2004/45 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera përafërta, i 24 gushtit 2006 (Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera përafërta); Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/26, për shpalljen e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, i 27 majit 2008 (Ligji për shoqëritë tregtare).

¹⁹ Neni 29(2), Ligji mbi gjykatat e rregullta.

²⁰ *Po aty, neni 30(1)(c)*.

²¹ Neni 194, Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera përafërta.

²² *Po aty, neni 213*.

²³ Neni 2, Ligji për markat tregtare.

²⁴ *Po aty, neni 85*, “pa i paragjykuar kompetencat që i jepen gjykatës me këtë ligj, për rastet nga nenet 20 ose 23 të këtij ligji do të jetë kompetente gjykata në vendin ku [...]” (theks i shtuar). Përdorimi i “may” [në gjuhën shqipe “mund të”] në vend të “shall” [në gjuhën shqipe “do të”] nënkupton që pala e pakënaqur mund të zgjedhë se në cilën gjykatë të paraqesë kërkesën e tij/saj. Megjithatë, përkthimi me përdorimin e termit “mund të” në versionin në gjuhën angleze të këtij neni ka një mospërputhje në përkthim, meqë versionet në gjuhën shqipe dhe serbe kanë përdorë termin “do të”.

²⁵ Neni 30(3), Ligji mbi gjykatat e rregullta.

jep këtë përgjegjësi Agjencisë Kosovare për Regjistrimin e shoqërive tregtare dhe markave tregtare.²⁶

Ligji në fuqi i vitit 2008 për procedurën kontestimore përmban shumë rregulla, në veçanti lidhur me kompetencën territoriale, disa nga të cilat duket se i heqin kompetencën Gjykatës ekonomike.²⁷ Për shembull, nëse pala e paditur është person juridik, kompetenca i takon gjykatës së territorit ku është e regjistruar selia e atij personit juridik,²⁸ deri sa në konteste të pronës gjykata me kompetencë ekskluzive është ajo gjykatë ku ndodhet prona e paluajtshme.²⁹

Madje, para se ligjet e reja dhe praktika ligjore të ndryshonin disa nga kompetencat që fillimisht i ishin dhënë Gjykatës Ekonomike, vetë Ligji i 1978 mbi Gjykatat e Rregullta ua shpërndante kompetencën mbi çështje të caktuara gjykatave të Kosovës.³⁰ Neni 30 i Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta gjithashtu është interpretuar si tillë që i jep kompetencë Gjykatës Ekonomike mbi rastet ku përfshihen palë që janë persona joprivatë.³¹ Një kompetencë e tillë, e bazuar në identitetin e palëve, ka ngritur pyetje të veçanta.

B. Kompetenca e bazuar kryesisht në identitetin e palëve është kundër idesë të një gjykate të specializuar në lloje të caktuara të kontesteve

Ndonëse emërtimi Gjykatë Ekonomike nënkupton një gjykatë të specializuar në lloje të caktuara të kontesteve, gjykata në fakt është e specializuar në raste që përfshijnë lloje të caktuara të palëve. Siç është përmendur më lart, Ligji mbi Gjykatat e Rregullta i numëron llojet specifike të procedurave për të cilat Gjykata Ekonomike ka kompetencë. Paragrafi i parë i nenit 30 të ligjit, i jep Gjykatës Ekonomike kompetencë në “kontestet reciproke ekonomike dhe kontestet për kompensimin e dëmeve në të cilat si palë janë organizatat e punës së bashkuar, organizatat apo bashkësitë tjera vetëqeverisëse dhe bashkësitë shoqëro-politike”. Shumica e lëndëve të gjykatës bazohen në këtë dispozitë, të cilën gjykata e ka interpretuar si të tillë që i jep kompetencë në raste në të cilat palët ndërgjyqëse janë persona joprivatë.³²

Ky rregull i kompetencës personale është në kundërshtim me idenë për të pasur gjykata të specializuara që merren me rastet nga një fushë e caktuar e ligjit. Personat privatë kanë mundësi të barabartë për t’u angazhuar në konteste ekonomike si korporata, dhe ata i meritojnë të njëjtat beneficione nga një gjykate e specializuar, nëse ka një të tillë.

²⁶ Neni 7, Ligji për shoqëritë tregtare. Është një agjenci që funksionon brenda Ministrisë për Tregti dhe Industri që i regjistron shoqëritë tregtare. Neni 6 dhe 7, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/26, për shpalljen e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, i 27 majit 2008.

²⁷ *Shih nenet* 37-62, Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, i 20 shtatorit 2008 (Ligji i procedurës kontestimore i 2008).

²⁸ *Po aty, neni* 39.2.

²⁹ *Po aty, neni* 41.1. Ligji i procedurës kontestimore i vitit 2008 asnjëherë nuk përmend “Gjykatën Ekonomike.” Ai përmend një “Gjykatë Tregtare” dhe “konteste tregtare” por nuk e përkufizon asnjërin nga këto dy terme. *Po aty, neni* 505 dhe *si vijon*.

³⁰ Neni 29 dhe 30, Ligji mbi gjykatat e rregullta.

³¹ Intervista të zhvilluara me gjykatës të Gjykatës Ekonomike dhe punonjës gjatë vjeshtës 2008.

³² *Po aty*.

Më tej, bazimi i kompetencës mbi identitetin e palëve nënkupton që kontestet ekonomike ndërmjet kategorive të ndryshme të palëve i nënshtrohen kompetencës së gjykatave të ndryshme. Kjo krijon një rrezik që gjykatat e ndryshme të nxjerrin aktgjykime të ndryshme për tema të ngjashme të lëndës. Për më tepër, legjislacioni nuk sqaron se cila gjykatë është kompetente në rast se një nga palët e shumta paditëse ose të paditura është person privat. Veç kësaj, kur kompetenca e Gjykatës Ekonomike bazohet në identitetin e palëve, e bënë të vështirë për gjykatësit që të fitojnë përvojë të specializuar në konteste ekonomike.

C. Terminologjia e vjetruar, e padefinuar dhe e paqartë e bëjnë të paqartë se cila është kompetenca lëndore e gjykatës

Në versionin origjinal të tekstit në gjuhën shqipe dhe serbe dhe versionin e përkthyer në gjuhën angleze të Ligjit mbi gjykatat e rregullta, kuptimi i disa termeve ligjore nuk është i qartë. Ligjet rrallë ofrojnë një listë hyrëse të përkufizimeve. Për shembull, në Ligjin e 1978 mbi gjykatat e rregullta, termet e përmendura, por të padefinuara përfshijnë: “deliktet ekonomike”, “kontestet administrativo-llogaritare”, “ujditë e detyrueshme”, dhe “kontestet ekonomike”.³³ Për më tepër, disa koncepte siç janë “kontestet reciproke ekonomike”, “organizatat e punës së bashkuar”, “organizatat vetëqeverisëse”, dhe “bashkësitë shoqërore-politike” janë relikte të ekonomisë së planifikuar të Jugosllavisë dhe kanë pak kuptim në mjedisin më modern dhe konkurrues të Kosovës.³⁴ Përkufizimet e disa prej këtyre termave gjinden në ligje tjera.

Ligji mbi deliktet ekonomike e përkufizon “deliktin ekonomik” si “shkelje të rregullave mbi afarizmin komercial dhe financiar të kryer nga një person ligjor dhe personi përgjegjës brenda personit ligjor, i cili ka shkaktuar apo mund të ketë shkaktuar pasoja të rënda dhe e cila në dispozitat e lëshuara nga organi i autorizuar specifikohet si delikt ekonomik.”³⁵ Për shembull, tregtia me mallra të pacertifikuara ose zhvillimi i aktivitetit tregtar të paregjistruar konsiderohet të jenë delikte ekonomike.³⁶ Për arsye të ndryshme, gjykata nuk i ka adresuar shumë raste të delikteve ekonomike në vitet e fundit. Në mënyrë të veçantë, inspektoratet komunale nuk janë aktive, pranë prokurorëve nuk bëhen kallëzime, këta të fundit nuk bëjnë ndjekje, ose në vend që të paraqiten pranë Gjykatës Ekonomike rastet paraqiten pranë gjykatës për kundërvajtje.³⁷

³³ Neni 30, Ligji mbi gjykatat e rregullta.

³⁴ *Po aty*, neni 30.1(a).

³⁵ Neni 2 (1), Ligji mbi deliktet ekonomike, Gazeta zyrtare e Republikës Federative të Jugosllavisë 4/1977, i 14 janarit 1977. Termi “delikt ekonomik” mund të jetë hutues meqë nuk i referohet domosdoshmërisht një veprë penale. Dënimet për delikte ekonomike përfshijnë gjoba, shpallje publike të aktgjykimeve, dhe përjashtim nga pjesëmarrja në ndonjë veprimtari të caktuar ekonomike. Nenet 17 dhe 20-35, Ligji mbi deliktet ekonomike, Gazeta zyrtare e Republikës Federative të Jugosllavisë 4/1977, i 14 janarit 1977 (Ligji mbi deliktet ekonomike). Rregullat e procedurës për adresimin e delikteve ekonomike gjinden në Ligjin mbi deliktet ekonomike dhe, në rast se delikti konsiderohet të jetë i natyrës penale, kodin e procedurës penale. “Pravna Enciklopedija, ISKRO Savremena Administracija, Beograd, 1985, faqe 1318; shih gjithashtu nenet 32(2) dhe 56, Ligji mbi deliktet ekonomike.

³⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/10, për shpalljen e Ligjit nr. 2003/5 për farërat, i 15 prillit 2003.

³⁷ Intervista të zhvilluara me gjykatës të Gjykatës Ekonomike dhe punonjës gjatë vjeshtës 2008.

“Kontestet administrativo-llogaritare”³⁸ i referohen padive kundër vendimeve të Shërbimit Shoqëror Llogaritar, subjekt me detyrë për mbajtjen e shënimeve të burimeve shoqërore dhe menaxhimin e pasurisë shoqërore.³⁹ Shërbimi Shoqëror Llogaritar nuk vepron më në Kosovë, duke e hequr kështu kompetencën e Gjykatës Ekonomike mbi kontestet administrativo-llogaritare.

Në kohën e themelimit të gjykatave ekonomike, “ujdi e detyrueshme”⁴⁰ ishte një marrëveshje mbi kthimin e parave dhe reduktimin e borxheve në mes të debitorit dhe “së paku gjysmës së numrit të përgjithshëm të kreditorëve, paditë e të cilëve kapin shkallën e më shumë se gjysmës së kërkesave të kreditorëve”.⁴¹ Ujditë e detyrueshme duket të jenë përdorur për t’i parandaluar procedurat e kushtueshme dhe të gjata të falimentimit, duke ua mundësuar ndërkohë kreditorëve mbledhjen e së paku një pjese të borxhit që duhet t’u paguhet.⁴² Gjykatat mund të urdhërojnë ujdi të detyrueshme gjatë seancave të njëjta paragjyqësore, në të cilat vendosin nëse janë plotësuar kërkesat për të proceduar me falimentim.⁴³ Në praktikën e tashme, ujdia e detyrueshme kuptohet si referim ndaj një procedure sipas së cilës Shërbimi Shoqëror Llogaritar kërkon që të iniciohet procedura e falimentimit për një subjekt të veçantë.⁴⁴ Megjithatë, Shërbimi Shoqëror Llogaritar nuk funksionon më.

Ndryshimi i rrethanave politike dhe ekonomike në Kosovë e ka hequr kompetencën e gjykatës për organizatat e punës së bashkuar, organizatat vetëqeverisëse dhe bashkësitë shoqërore-politike. Për më tepër, gjykimi i delikteve ekonomike, kontesteve administrative-llogaritare, ujdive të detyrueshme dhe kontesteve ekonomike bëhet edhe më i vështirë pasi që shumica e këtyre termeve e kanë humbur kuptimin e tyre në kontekstin aktual ligjor. Kur të shikohen dispozitat e Ligjit mbi gjykatat e rregullta që e përcaktojnë kompetencën e Gjykatës ekonomike, mund të thuhet që zhvillimet historike ia kanë marrë gjykatës së paku gjysmën e kompetencës së saj. Për më tepër, ndryshimet ligjore dhe sociale vetëm sa do ta vazhdojnë këtë dukuri.

D. Ekzistimi i gjykatave të ndryshme me kompetencë të njëjtë

Kompetenca e njëjtë e Gjykatës Ekonomike me gjykata tjera, përveç që paraqet një sfidë si e tillë, gjithashtu ofron edhe mundësi për palët ndër-gjyqëse që duhet të vendosin për gjykatën në të cilën do ta paraqesin kërkesën e tyre. Ato mund ta kërkojnë vetë organin gjyqësor për të cilin mendojnë që do t’i shërbejë më së miri qëllimeve të tyre dhe kjo praktikë do të mund të sjellë deri të rezultatet e ndryshme në çështje të njëjta, përkundër asaj që përfundimet nuk do të duhej të varen nga ajo se cila gjykatë e shqyrton lëndën. Njëkohësisht, gjykatat që tashmë janë të mbingarkuara me lëndë, siç janë gjykata komunale dhe e qarkut në Prishtinë, do të mund të shohin

³⁸ Neni 30(1)(ç), Ligji mbi gjykatat e rregullta. Shih gjithashtu “Pravna Enciklopedija 1 ISKRO Savremena Administracija, Beograd”, 1985, faqe 1785.

³⁹ “Pravna Enciklopedija”, faqe 1529, ku citon Ligjin mbi shërbimin shoqëror llogaritar dhe nenin 77 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, e viti 1974.

⁴⁰ Neni 30.2, Ligji mbi gjykatat e rregullta.

⁴¹ “Pravna Enciklopedija”, faqe 1300.

⁴² *Shih po aty.*

⁴³ Intervista të zhvilluara nga punonjës të OSBE-së me gjykatës të Gjykatës Ekonomike dhe ish-punonjës gjatë vjeshtës 2008.

⁴⁴ Intervista të zhvilluara nga punonjës të OSBE-së me gjykatës të Gjykatës Ekonomike dhe punonjës gjatë vjeshtës 2008.

ritje të kësaj ngarkese nëse parashtruesit e kërkesave i konsiderojnë ato të jenë organe më të favorshme gjyqësore.

Për më tepër, kjo mund të ketë ndikim në menaxhimin e sistemit gjyqësor. Gjykatat mund të deklarohen si jokompetente dhe t'i referojnë çështjen ndonjë gjykatë tjetër, duke shkaktuar vonesa dhe huti në një sistem tashmë të ngarkuar të drejtësisë. Në një lëndë të vitit 2003 që e ka monitoruar OSBE-ja dhe kishte të bëjë me dy persona juridik, gjykata e deklaroi si të pazbatueshme dispozitën e Ligjit mbi gjykatat e rregullta të vitit 1978 në lidhje me kompetencën e gjykatës ekonomike për shkak se tema e “[...] kontestit është pagesa e qirasë dhe nuk ka të bëjë me një marrëdhënie ndër-afariste ndërmjet dy personave juridik” Gjykata ia ktheu rastin për rishqyrtim gjykatës komunale në bazë të dispozitës së Ligjit mbi gjykatat e rregullta sipas së cilës gjykatat komunale kanë kompetencë “të gjykojnë kontestet mbi denoncimin e kontratës së huapërdorjes ose mbi kontratën e qirasë së sendeve, apo të lokaleve afariste, si dhe kontestet nga marrëdhëniet banesore; po që se janë në kompetencën e gjykatave të rregullta.”⁴⁵ Ka mundësi që pagesa e qirasë për lokale afariste prej një personi juridik në tjetrin do të mund të hynte brenda definicionit të kontestit reciprok ekonomik.

Mungesa e rregullave të qarta të kompetencës që e caktojnë një gjykatë të vetme me kompetencë për një çështje të caktuar mund të sjellë deri te kontestet ndërmjet palëve, ndërmjet gjykatave dhe ndërmjet palëve dhe gjykatave. Në përgjithësi, ajo do të mund të krijonte huti për publikun, palët dhe punonjësit gjyqësor.

Për t'i ndërlikuar gjërat edhe më tej, Ligji mbi Gjykatat e Rregullta, i vitit 1978, dhe Ligji mbi procedurën kontestimore, i vitit 2008, kanë rregulla të ndryshme për zgjidhjen e kontesteve për kompetencë. Sipas Ligjit mbi gjykatat e rregullta, Gjykata Supreme e Kosovës “vendos kontestet për kompetencë midis gjykatave të rregullta dhe gjykatave të punës së bashkuar dhe kontestet për kompetencë midis gjykatave të rregullta dhe gjykatave të tjera vetëqeverisëse në territorin e Krahinës”⁴⁶ Sipas Ligjit për procedurën kontestimore, të vitit 2008, konfliktin lidhur me kompetencën midis gjykatave të llojit të njëjtë e zgjidh gjykata që është më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt.⁴⁷ Konfliktin lidhur me kompetencën midis gjykatave të llojit të ndryshëm e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës.⁴⁸ Për më tepër, sipas nenit 43 të Ligjit për procedurën kontestimore, kompetencë për kontestet që kanë lidhje me procedurën e falimentimit apo lindin gjatë saj ka gjykata, në territorin e së cilës është duke u kryer ajo procedurë. Të gjitha këto mund të shkaktojnë konteste lidhur me kompetencën.

Kuptimi dhe interpretimi i paqartë i identitetit të palëve të përmendura në nenin 30(1)(a) të Ligjit mbi gjykatat e rregullta gjithashtu mund të jetë burimi i kontesteve të kompetencës, mirëpo ky rrezik është i vogël pasi që punonjësit e zyrës së regjistrimit të gjykatës ekonomike thonë që gjykata merr kompetencën nëse të dy palët janë të përfshira në Regjistrin e organizatave të biznesit.⁴⁹

⁴⁵ Neni 26(13), Ligji mbi gjykatat e rregullta.

⁴⁶ Neni 31(8) Ligji mbi gjykatat e rregullta.

⁴⁷ Neni 25.1, 2008 Ligji për procedurën kontestimore.

⁴⁸ *Po aty*, neni 25.2.

⁴⁹ Intervistat që OSBE i ka bërë me gjykatësit dhe punonjësit tjerë të Gjykatës ekonomike në tetor dhe nëntor të vitit 2008.

Shpeshherë ndodhin vonesa në rastet kur gjykatat e refuzojnë kompetencën për një lëndë dhe ia referojnë atë një gjykate tjetër. Në lëndët që janë monitoruar, baza për ta refuzuar kompetencën e gjykatës ekonomike kryesisht kishte të bënte me mungesën e definicionit të qartë të “kontestit reciprok ekonomik” nga neni 30 i Ligjit mbi gjykatat e rregullta.

Vonesat gjithashtu ndodhin kur një palë e kundërshton vendimin lidhur me kompetencën ose kur palët e parashtrojnë kërkesën e njëjtë në gjykata të ndryshme dhe secila nga gjykatat merr një vendim të ndryshëm lidhur me kompetencën, ku pastaj do të vendosë Gjykata Supreme.⁵⁰ Konfliktet të tilla të gjata procedurale nënkuptojnë që mund të kalojnë vite të tëra para se të gjykohet tema e lëndës, duke e rritur kështu rrezikun për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor

Në një konflikt në lidhje me një kontratë në rajonin e Gjilanit, pala paditëse ia parashtroi kërkesën fillestare gjykatës komunale në tetor të vitit 2001. Gjykata komunale deklaroi që lënda është jashtë kompetencës së saj për shkak se ka të bëjë me një konflikt ekonomik ndërmjet një organizatë të punës dhe një “bashkësie shoqërore-politike” dhe ia referoi çështjen Gjykatës ekonomike. Pala paditëse u ankua, mirëpo gjykata e qarkut e vërtetoi vendimin e gjykatës komunale duke u bazuar në nenin 30 të Ligjit mbi gjykatat e rregullta, sipas të cilit Gjykata Ekonomike gjykon në kontestet ndërmjet dy personave juridik. Mirëpo, Gjykata Ekonomike ia ktheu lëndën gjykatës komunale me arsyetim që “konflikti ekonomik” nga neni 30 nënkupton “konfliktin nga marrëdhënia reciproke ekonomike në lidhje me afarizmin e subjekteve nga neni 30(1)(a) i Ligjit mbi gjykatat e rregullta. [...].

Kjo lëndë nuk ka të bëjë me një konflikt reciprok ekonomik por më parë me anulim të një kontrate mbi shkëmbimin e pronës së paluajtshme, që nuk përbën konflikt reciprok ekonomik por kontest civil pasuror-juridik, për të cilin ka kompetencë gjykata komunale, sipas nenin 26(1)(6) të Ligjit mbi gjykatat e rregullta.” Në pajtim me nenin 22(1) të Ligjit mbi procedurën kontestimore, të vitit 1982, Gjykata Ekonomike ia referoi çështjen e kompetencës Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila e vërtetoi vendimin e Gjykatës Ekonomike dhe ia ktheu lëndën gjykatës komunale më 31 dhjetor 2002. Më 6 maj 2006, gjykata komunale vendosi në favor të palës së paditur. Pala paditëse u ankua në gjykatën e qarkut, e cila e anuloi vendimin e gjykatës komunale më 28 qershor 2006. Pala e paditur paraqiti kërkesë për rishqyrtim në Gjykatën Supreme më 15 mars 2007 – gati pesë vjet e gjysmë që kur pala paditëse e kishte parashtruar kërkesën fillestare.⁵¹

⁵⁰ Neni 31(8), Ligji mbi gjykatat e rregullta.

⁵¹ Ka më pak gjasa që vonesa të tilla të ndodhin me zbatimin e Ligjit për procedurën kontestimore, të vitit 2008, pasi që neni 26.3 i këtij ligji nuk lejon ankimin kundër aktgjykimeve mbi konfliktin për kompetencë.

E. Zvogëlimi i numrit të lëndëve në gjykatë vë në pyetje nevojën për një gjykatë ekonomike në formën e tashme

Zbehja e kompetencës së Gjykatës ekonomike, e shkaktuar nga zhvillimet ligjore dhe ekonomike në Kosovë, ka sjellë deri te zvogëlimi i numrit të lëndëve. Shumë organizata që përmenden në nenin 30(1)(a) të Ligjit mbi gjykatat e rregullta, siç janë organizatat e punës së bashkuar, organizatat vetëqeverisëse dhe bashkësitë shoqërore-politike nuk ekzistojnë më, janë transformuar në ndërmarrje në pronësi shoqërore,⁵² ose janë privatizuar. Veprimet ligjore në lidhje me këto ndërmarrje duhet t'i drejtohen Dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, e jo Gjykatës ekonomike.⁵³ Siç është sqaruar më lart, kontestet administrativo-llogaritare dhe procedurat e ujdisë së detyrueshme nuk ndodhin më.

Në pajtim me këtë, numri i lëndëve pranë Gjykatës Ekonomike ka qenë i kufizuar në vitet e fundit. Në vitin 2007, Gjykata Ekonomike nuk ka pranuar apo proceduar asnjë lëndë nga kategoria e delikteve ekonomike, likuidimeve të rregullta, falimentimeve, urdhërpagesave dhe çështjeve jokontestimore.⁵⁴

Përveç gjykimit të një numri më të vogël të kontesteve, Gjykata Ekonomike më nuk është përgjegjëse për mbajtjen e regjistrit të bizneseve. Kjo detyrë kjo tash i takon Ministrisë së tregtisë dhe industrisë.⁵⁵

Gjykata Ekonomike ishte themeluar në kohën kur qeveria qendrore luante një rol shumë më të madh në politikën ekonomike dhe biznesi ishte i strukturuar në një mënyrë që e përfill kontrollin e tillë qendror. Ndryshimet politike dhe ekonomike prej themelimit të Gjykatës Ekonomike kanë sjellë deri te një zvogëlim i konsiderueshëm i numrit të lëndëve. Në mënyrë që të shmanget rreziku që Gjykata Ekonomike të dalë jashtë funksionit, korniza ligjore në bazë të së cilës ajo vepron duhet të rishikohet dhe modernizohet në masë të madhe.

III. PRAKTIKA E GJYKATËS EKONOMIKE

A. Shkelja e garancive për dëgjim publik nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

E drejta për dëgjim publik shkon më tej se mbajtja e gjykimeve të hapura. Ajo “gjithashtu vlen edhe për shpalljen publike të aktgjykimeve [...] dhe ka të njëjtin

⁵² Neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/18 për ndryshimin e Rregullores nr. 2002/12 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e datës 22 prill 2002; Neni 2(1) dhe (2), Ligji mbi ndërmarrjet, Gazeta zyrtare nr. 77/1988 e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, e datës 31 dhjetor 1988.

⁵³ Neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e lidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ashtu si është ndryshuar me Rregulloret e UNMIK-ut nr. 2008/4 dhe 2008/19.

⁵⁴ Intervistat me gjykatësit dhe punonjësit e Gjykatës ekonomike gjatë vjeshtës së vitit 2008.

⁵⁵ Kjo është një agjenci në kuadër të Ministrisë së tregtisë dhe industrisë që i regjistron organizatat e biznesit. Nenet 6 dhe 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/2 për shpalljen e Ligjit nr. 02/L-123 për organizatat e biznesit, më 27 maj 2008.

qëllim, përkatësisht gjykimin e drejtë”.⁵⁶ Gjykata Ekonomike mban dëgjime publike dhe i shpall aktgjykimet në mënyrë publike, mirëpo publiku nuk ka qasje të gatshme në kopjet e aktgjykimeve pasi që ato nuk publikohen në ndonjë gazetë zyrtare apo në internet. Ky është një problem jo vetëm i kësaj gjykate, por i tërë gjyqësorit të Kosovës. Me përjashtim të disa vëllimeve të shtypura dhe CD-ve me aktgjykime të Gjykatës Supreme, që janë publikuar në të kaluarën.

Vendimet publike rrisin transparencën, monitorimin kritik publik dhe besimin në sistemin e drejtësisë, si dhe i edukojnë juristët se si ta interpretojnë ligjin. Për më tepër, palët që mendohen të ngritin padi pranë Gjykatës Ekonomike mund të përballen me probleme nëse dëshirojnë t’i shqyrtojnë aktgjykimet e mëparshme të Gjykatës Ekonomike për çështjen e njëjtë. Prandaj, Gjykata Ekonomike dhe të gjitha gjykatat e Kosovës duhet t’i publikojnë rregullisht vendimet relevante.

Gjithashtu, praktika e Gjykatës Ekonomike për t’i mbajtur seancat dëgjimore në zyra të gjykatësve, në të cilat ka vend vetëm për disa persona, është më pak e dëshirueshme në kuptim të pajtueshmërisë së plotë me garancitë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje për dëgjim publik.⁵⁷

Në fund, Gjykata Ekonomike nuk e publikon orarin e seancave dëgjimore, duke i shkelur kështu mundësisht dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave një gjykim është në pajtim kërkesën për të qenë publik vetëm atëherë kur publiku mund të marrë informata lidhur me datën dhe vendin ku do të mbahet gjykimi, si dhe ka qasje të lehtë në atë vend.⁵⁸

B. Aktgjykimet e Gjykatës Ekonomike shpeshherë nuk kanë arsyetim të mjaftueshëm

Palët në gjykime ekonomike, sikur në të gjitha gjykimet tjera civile, kanë të drejtë për një vendim të arsyetuar.⁵⁹ Në pajtim me kërkesën për një vendim të arsyetuar, sipas Ligjit mbi procedurën kontestimore, të vitit 1982, kërkohet që vendimi përfundimtar të përmbajë një sqarim ku përfshihen të gjitha faktet dhe provat në të cilat është i bazuar vendimi.⁶⁰ Gjykata gjithashtu do t’i specifikojë dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi.⁶¹ Mungesa e arsytimit të vendimit paraqet shkelje të konsiderueshme të ligjit të procedurës dhe shërben si bazë për ankim.⁶²

⁵⁶ *Werner kundër Austrisë*, nr. i apl. 21835/93, par. 54, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, më 24 nëntor 1997.

⁵⁷ *Shih Riepan kundër Austrisë*, nr. i apl. 35115/97, par. 30, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, më 14 nëntor 2000.

⁵⁸ *Po aty*, par. 29.

⁵⁹ *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. i apl. 16034/90, par. 61, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 19 prill 1994. *Shih gjithashtu Suomenin kundër Finlandës*, nr. i apl. 37801/97, par. 34-38, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 24 korrik 2003.

⁶⁰ Neni 338(1), Ligji mbi procedurën kontestimore, i vitit 1982. Referenca i bëhet këtij ligji për shkak se lëndët që janë monitoruar i takojnë kohës para miratimit të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008.

⁶¹ *Po aty*, Neni 338(4).

⁶² *Po aty*, Neni 354(2)(13). Sipas nenit 354(1) të Ligjit mbi procedurën kontestimore, të datës 1982, një “shkelje e konsiderueshme në kuptim të praktikës dhe procedurës ekziston nëse gjykata, gjatë zhvillimit të procedurës, nuk ka zbatuar ose ka zbatuar gabimisht ndonjë dispozitë të këtij ligji, e që ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë”.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut kërkon aktgjykime të arsyetuara. Vendimi i arsyetuar “u tregon palëve që ato janë dëgjuar [...]. Vetëm përmes ofrimit të vendimit të arsyetuar mund të arrihet te monitorimi kritik publik i administrimit të drejtësisë.”⁶³ Vendimet e arsyetuara janë posaçërisht të rëndësishme për shkak se ua japin mundësinë palëve që të ankohen. Është e vërtetë që pa arsytet që e arsyetojnë një vendim të gjykatës, pala ankimore nuk mund ta kontestojë si duhet bazën e vendimit të gjykatës.⁶⁴

Aktgjykimet e Gjykatës Ekonomike shpeshherë nuk kanë arsytetim të mjaftueshëm dhe në to nuk citohen dispozitat mbështetëse ligjore. Për më tepër, gjykata shpeshherë nuk ofron ndonjë sqarim lidhur me atë se si provat e paraqitura në gjykim i përmbushin kërkesat sipas ligjit.

Më 25 prill 2006, në një lëndë që kishte të bëjë me një borxh mes dy personave juridikë, Gjykata Ekonomike e aprovoi padinë e palës paditëse dhe e obligoi palën e paditur që ta paguajë borxhin. Lënda ishte përcjellë nga Gjykata Supreme në Gjykatën ekonomike, dhe aktgjykimi thotë që Gjykata Ekonomike “[...] i administroi provat gjatë procedurës së dhënies së provave, duke e shqyrtuar në mënyrë të drejtpërdrejt aktgjykimin e Dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme [...], njoftimin e AKM-së [...], certifikatën për këmbim të valutës, vendimin e Gjykatës komunale në Istog, aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike [...] provat e marra nga dëgjimi i dëshmitarit [...] siç ka propozuar pala paditëse” Më tej, “[...] duke u bazuar në bazat e vërtetuara të gjendjes faktikë dhe në pajtim me nenet 17, 17 dhe 262 të Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore, gjykata e obligon palën e paditur që të paguajë [...] për shkak se palët ndërgjyqëse obligohen përmes marrëdhënieve detyrimore-kontraktuese që t’i përmbushin detyrimet e tyre dhe kanë përgjegjësi që t’u përmbahen këtyre obligimeve, prandaj pala e paditur obligohet që ta kryejë detyrimin e saj në tërësi, ashtu si ishte paraparë më herët”. Edhe pse në aktgjykim janë theksuar dispozitat ligjore që e mbështesin vendimin e gjykatës, aty nuk është ofruar ndonjë sqarim se si provat e paraqitura i përmbushin kërkesat sipas ligjit.⁶⁵

Më 31 dhjetor 2001, në një rast në lidhje me markat tregtare, pala paditëse kërkoi nga gjykata që ta ndalojë palën e paditur që ta distribuojë produktin në fjalë. Më 11 shkurt 2002, gjykata e refuzoi kërkesën e palës paditëse duke u thirrur në mungesë të provave dhe duke iu referuar nenit 267 të Ligjit për procedurën përbarimore dhe nenit 278 të Ligjit për procedurën kontestimore, pa ndonjë arsytetim shtesë. Më 28 shkurt 2002, gjykata nxjerr një aktgjykim me të cilin e hodhi poshtë padinë e palës paditëse. Në aktgjykim, gjykata përshkruan provat e paraqitura por nuk përmend dispozitat ligjore: “[...] pala paditëse nuk ka legjitimitet aktiv të një pale paditëse dhe e njëjta është i përfaqësuar si distributor [i produktit] dhe nuk ndonjë autorizim tjetër që në një emër dhe për

⁶³ *Suominen kundër Finlandës*, nr. i apl. 37801/97, par. 37, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 24 korrik 2003.

⁶⁴ *Po aty*. Paragrafët 34-38.

⁶⁵ Ligji mbi marrëdhëniet detyrimore, Gazeta zyrtare nr. 28/1978 e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, e datës 30 mars 1978.

prodhuesin [e produktit] kërkojnë themelimin e identitetit të markës së kontestuar [...] dhe ndalimin e distribuimit [të produktit].”

IV. KONKLUDIM

Ligjet e reja që qe i japin gjykatave tjera kompetencën për çështjet mbi të cilat tradicionalisht ka vendosur zgjidhur Gjykata ekonomike, terminologjia e vjetruar dhe e padefinuar, dalja nga përdorimi i termave si “organizatat vetëqeverisëse” dhe “organizatat e punës së bashkuar” nënkuptojnë që Gjykata Ekonomike duhet t’i adaptohet rrethanave të reja në mënyrë që ta përmbushë mandatin e saj me sukses. Për më tepër, praktika e ushtrimit të kompetencës personale më parë se asaj sipas temës së lëndës shpeshherë i humb kuptimin qëllimit të një gjykate të specializuar në një fushë të caktuar të ligjit. Gjykata ekonomike, në formën e saj të tashme, qëndron në masë të madhe si një relik e një kohe kur shteti ishte faktori kryesor lëvizës i ekonomisë së Kosovës. Nëse Gjykata nuk i adaptohet rrethanave aktuale, ekziston rreziku që të dalë plotësisht jashtë funksionit.

V. REKOMANDIMET

- Nëse Gjykata Ekonomike mbetet në formën e saj të tashme si një gjykatë e ndarë e qarkut me kompetencë për tërë Kosovën, korniza ligjore në bazë të së cilës ajo vepron duhet të rishikohet dhe modernizohet.
- Nëse Kosova vazhdon të ketë një Gjykatë Ekonomike, rregullat lidhur me kompetencën e saj do të duhej të përshkruhen në një ligj dhe kjo kompetencë nuk duhet të varet nga natyra e palëve si persona fizikë apo juridikë. Gjykata Ekonomike do të mund të ketë kompetencë ekskluzive për të gjitha kontestet që dalin nga ligje të caktuara, siç janë Ligji për Organizatat e Biznesit, Ligji për falimentimin, Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta, dhe Ligji për markat tregtare.
- Një komplet gjithëpërfshirës dhe modern i rregullave do të duhej ta përcaktonte kompetencën për të gjitha gjykatat e Kosovës.
- Rregullat për zgjidhjen e kontesteve të kompetencës duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të ofruara brenda një ligji. Ato do të duhej adresojnë në mënyrë të qartë kontestet në të cilat është e përfshire Gjykata ekonomike.
- Gjykata Ekonomike duhet t’i publikojë rregullisht aktvendimet dhe oraret e gjykimeve, dhe t’i mbajë seancat e gjykimit në salla që janë të mëdha sa duhet për ta pranuar publikun.
- Gjykata Ekonomike do të duhej të garantojë që aktvendimet janë të arsyetuara në mënyrë të plotë dhe përmbajnë referencat në dispozitat e caktuara ligjore në të cilat është i bazuar aktvendimi, si dhe faktet që i përkrahin ato aktvendime.